

Ibrahim Rugova

## INTERPRETIME METODOLOGJIKE E TEORIKE TË KRITIKËS LETRARE

### 1. Akseptime hyrëse

Nëse nisemi nga mendimi se në një shqyrtim nuk është i rëndësishëm vetëm rezultati, po edhe rruga deri te ai,<sup>1</sup> që do të thotë se, për ta vështruar një rezultat, duhet ta njohim edhe mënyrën, metodën, e cila e kushtëson atë, me këtë rast do të bëjmë fjalë mbi kritikën letrare në Kosovë, mbi rrugën e saj deri te rezultati, mbi metodologjinë dhe mbi bazën teorike të saj. Po para se të hyjmë në shqyrtimin konkret të kësaj çështjeje, po bëjmë një vështrim të përgjithshëm mbi kritikën letrare në përgjithësi, mbi metodat e saj, në bazë të të cilave përcaktohen edhe orientimet në kuadër të saj. Edhe një shpjegim: termin *metodë* e përdorim në kuptim të teorive poetologjike dhe estetike, që na ndihmon të gjejmë diçka të përbashkët në orientimet e ndryshme të kritikës, të studimit të letërsisë, respektivisht të shkencës mbi letërsinë.

### 2. Mbi konceptin dhe mbi metodat e kritikës

Përkufizimi i konceptit të kritikës është një çështje e vështirë, meqë ajo vazhdimisht oscilon midis dishiplinave të tjera që merren me studimin e letërsisë dhe gjendet në relacione reciproke me to në kuadër të shkencës mbi letërsinë. Termin *kritikë* njëherë po e vështrojmë në kontekst më të gjerë. Fjala kritikë vjen nga shprehja e greqishtes *kribis*, që do të thotë: shkëputje, shqyrtim, kontest, zënkë, dallim, vendim, sprovim, gjykim, përshtresim, madje edhe në kuptimin gjyqësor: padi, e drejtë, gjykim, drejtësi, dënim. Emrit *kribis* i përgjigjet folja *krino*, që ka këtë kuptim: të veçosh, të votosh të zgjedhësh, të gjykos, të konsiderosh, të dënosh, të padisësh, të

<sup>1</sup> Mendim i Marksit, sipas Dr. Djuro Sušnjić, *Kritika sociološke metode*, Niš, 1973, f. 9. Një mendim të tillë e thotë edhe Milivoj Solar në librin *Ideja i priča*, Liber, Zagreb, 1974, f. 240, por pa theksuar se është i Marksit.

shqyrtosh. Forma latine — *cerno* e kësaj foljeje, në njëfarë dore humb diçka nga kuptimi juridik dhe do të thotë: të veçosh, të zgjedhësh, të shikosh, të vësh, të njohësh, të kuptosh, të vendosësh, të bashkosh, të gjykosh.<sup>2</sup> Tash mund të përmbledhim kuptimin burimor të kritikës që do të thotë: të zbrëthesh të shkoqitish, të vendosësh mbi diçka, kurse në kuptimin e sotëm ka humbur atë kuptimin e sanksionit juridik, po i ka ruajtur dimensionet kuptimore të vendosjes, të kontestit, të zgjedhjes, të gjykimit, të zgjidhjes dhe të përshtresimit. Pra kuptimi semantik i kritikës përmban në vete një proces brenda të cilit realizohet konkretizimi i konceptit të saj që është i lidhur me ndonjë sistem të vlerave. Si i tillë termi kritikë ka një përdorim të gjerë në të gjitha sferat e veprimtarisë intelektuale njerëzore si dhe në jetën e përditshme. Në literaturën speciale kritika përkufizohet si pjesë e logjikës që trajton gjykimin, apo si shqyrtim i një parimi a fakti me qëllim që të jipet një gjykim. Kanti kritikën e merr si shqyrtim të lirë, të hapur, publik.<sup>3</sup> Merret edhe si art i të gjykuarit të veprave shpirtërore, të veprave letrare, artistike e filozofike, e po ashtu edhe si gjykim estetik.<sup>4</sup> Në filozofi mjafton të përmenden tri „kritikat” e njohura të Kantit: *Kritika e mendjes së kulluar*, *Kritika e mendjes praktike* dhe *Kritika e forcës së gjykimit*, pastaj vepra e njohur e Marksit *Kapitali*, që si nëntitull mban shenjë „Kritikë ekonomisë politike”, po që nuk bie në kritikizmin idealist subjektiv të Kantit. Kjo do të thotë se kritika është një „lejë” e fortë për të pranuar diçka, që më parë duhet të vlerësohet dhe të shqyrtohet mirë e mirë e pastaj të pranohet. Kështu edhe nga filozofia marksiste del se çdo gjë duhet të pranohet në mënyrë kritike, madje edhe vetë realiteti si fundament i botës shoqërore dhe shpirtërore.

T’i kthehemi tash kritikës letrare. Në këtë vështrim edhe kritika letrare përmban shumëçka nga kuptimi i përgjithshëm i kritikës. E thamë më parë se kritika si dishiplinë e studimit të letërsisë (e shkencës mbi letërsinë) qëndron midis dishiplinave të tjera të këtij studimi. Por në kuadër të këtyre dishiplinave shfaqet një problem tjetër: përderisa kritika filozofike, kritika shkencore hyjnë në ato fusha si përbërës i tyre, kritika letrare, për shkak të objektit të saj, nuk hyn as në shkencën e letërsisë e as në artin letrar, po shpesh ndodh që të futet në vetë letërsinë. Rreth kësaj çështjeje ekzistojnë mendime të ndryshme nga kritikët dhe studjuesit e letërsisë. Kritika letrare herë merret si „një ligjëratë shkencore mbi letërsinë”, e herë si „letërsi mbi letërsinë”. Në kritikën si shkencë i inkuadrojnë shkrimet e kritikëve, e në kritikën si letërsi shkrimet e shkrimtarëve mbi letërsinë. Për ta nxjerrë më mirë konceptin e kritikës po sjellim një shqyrtim tjetër mbi korrelacionet dhe distinkcionet midis di-

<sup>2</sup> Niko Grafenauer. *Pesništvo i kritika* në Treçi program RB, nr. 12/1972, f. 126.

<sup>3</sup> Andre Lalande. *Vocabulaire technique et critique de philosophie*, Presses Universitaires de France, Paris, 1972, f. 196–197.

<sup>4</sup> Peti Robert, *Dictionnaire de la langue française*, Paris, 1970, f. 383. (I faldenderohem R. Ismajlit që më ndihmoi në konsultimin e referencave 3 e 4 në gjuhën frënge).

shiplinave të studimit të letërsisë siç janë: teoria e letërsisë, historia e letërsisë e estetika.

Teoria e letërsisë, që ndërlidhet me poetikën klasike dhe me retorikën, ka ruajtur disa elemente të tyre, po ka ardhur gjithnjë duke u pasuruar, duke u sistemuar në kuadër të përvojës bashkëkohëse. Edhe sot përdoret termi poetikë për të përcaktuar teknikën dhe prosedeun e një veprë apo të një letërsie të tërë; ekziston poetika praktike që nxjerr parime për një vepër dhe për një letërsi dhe poetika përgjithësuese që nxjerr parime të përgjithshme. Sot poetika nuk konsiderohet si normativë, e tillë, çfarë ishte në klasicizëm sidomos, që nisej nga rregullat a priori për të vlerësuar veprën, po të shumtën e herave këto i nxjerr a posteriori, do të thotë se gjatë studimit të veprës i nxjerr, i sistemon dhe i përgjithëson në një mënyrë relative. Kështu shpesh, poetikën, respektivisht teorinë e quajnë edhe shkencë të letërsisë, sidomos në shkollën gjermane të studimit, por me këtë rast duhet të theksojmë se sot me termin shkencë e letërsisë, si *literaturwissenschaft* nënkuptohet i gjithë studimi i letërsisë, i të gjitha dishiplinave të tij. Historia e letërsisë, që u zhvillua sidomos në shekullin XIX dhe në shekullin tonë, veprat letrare dhe letërsinë në përgjithësi i shqyrton në kontekstin suksesiv e sintetizues të vlerave gjatë periodave të ndryshme të zhvillimit dhe të pasurimit të letërsisë. Estetika, si dishiplinë e filozofisë së përgjithshme mbi artin, si filozofi mbi artin, apo, nëse mund të themi në kuptimin aplikativ estetika e letërsisë e konkretizon raportin midis veprës dhe pranuesit në procesin e përjetimit të saj, e cila e zbulon qenësinë estetike që përmban ajo. Kritika letrare qëndron midis këtyre dishiplinave në kuadër të shkencës së letërsisë dhe me rastin e shqyrtimit të veprës letrare merr nga të gjitha këto, apo orientohet në njërën prej tyre. Por këtë nuk duhet ta kuptojmë si eklektizëm të kësaj dishipline, e cila nuk e ka qëndrimin e vet, po siç e theksuam, qëndron në relacion të barabartë dhe reciprok me to, që edhe merr e edhe jep. Po të nxjerrim një përgjithësim teorik do të shohim se kritika qëndron midis *theorisit* dhe *praksisit*, pra midis teorisë dhe praktikës. Njëherësh ajo e krijon teorinë dhe e zbaton atë në fushën e vet, në vlerësimin e veprës. Kritika krijon mundësi që të shfaqen teoria dhe dishiplina të tjera, sepse ajo së pari vendos kontakt të drejtpërdrejtë me artin letrar. Me këtë distinkcion, njëherë për njëherë, e vështruam kritikën në këtë kuadër, që do të thotë se ajo nuk hyn as në teorinë e letërsisë, as në historinë e letërsisë e as në estetikë.

Është interesant mendimi i Rolan Bartit se, kritika nuk hyn në shkencë, sepse shkenca i hulumton kuptimet, e kritika i prodhon ato. Ajo zë vendin e ndërmjetësuesit midis shkencës dhe leximit. Midis kritikës e veprës gjendet i njëjti relacion si midis kuptimit dhe formës... Ajo nuk e „përkthen” veprën, po mund të „krijojë”

njëfarë kuptimi, të cilin e nxjerr nga forma që paraqet veprën.<sup>5</sup> Po japim një koment: kritika nuk qëndron më, në atë kuptimin klasik, si „urë“ midis lexuesit dhe veprës, por ajo është si një ndërmjetësues krijues në këtë relacion, i krijon kuptimet e reja mbi veprën, hyn në një aktivitet kreativ.<sup>6</sup>

Edhe zhvillimi historik i kritikës mund të na ndihmojë ta zëmë më mirë konceptin e saj. Kritika si kritikë letrare i ka fillet në antikë, madje konfrontimet e para midis poezisë mitologjike greke dhe filozofisë, në njëfarë mënyre konsiderohen si kritikë e parë.<sup>7</sup> Po më konkretisht këtë e bën Aristoteli në kapitullin XXV të *Poetikës* së tij kur flet mbi problemet dhe mbi zgjidhjen e tyre që paraqiten në artin poetik.<sup>8</sup> Ai kritikën e merr si zgjidhje të problemeve lidhur me artin letrar. Dallon dy lloje gabimesh që kanë të bëjnë me këto probleme: gabimet ndaj artit poetik dhe gabimet ndaj rregullave të poetikës. Prej këndeje dalin edhe dy orientime të mëvonshme: poetika kreative dhe ajo normative, e që në kohën tonë ka rënë ajo normative. E përmendëm Aristotelin, sepse kritikën e merr si zgjidhje të çështjeve dhe të problemeve, e që i afrohet konceptit që po e shqyrtojmë. Mirëpo shekulli XVIII dhe shekulli XIX, siç thotë Rene Veleku, janë shekuj të kohës së kritikës, e shekulli XX është gjithsesi epokë e kritikës në vështrimin e plotë të fjalës.<sup>9</sup> Shekulli XX mund të konsiderohet si epokë e kritikës, meqë në kuadër të tij bëhet dezintegrimi i drejtimeve kritike duke hudhur pozitivismin e Sent-Bevit dhe të Ypolit Tenit. Ky dezintegrim mund të lidhet edhe me dezintegrimin që ngjet me drejtimit letrare në fillim të këtij shekulli, të cilat shndërrohen në rryma të ndryshme. Pra në shekullin tonë nuk kemi më drejtime, apo metoda dominuese, as në letërsi e as në kritikë, pa absolutizime. Të gjitha metodat e kritikës së sotme janë të drejtuara si reaksion ndaj pozitivismit, pra zhvillohen në frymën e antipositivismit. Pikëvështrimi i shqyrtimit të letërsisë bartet nga faktografia pozitiviste në veprën letrare.

E thamë edhe njëherë se kritika, për ta realizuar qëllimin e vet, ajo mbështetet në metodat e ndonjë teorie filozofike apo estetike dhe kështu krijon qenësinë e vet. Në bazë të këtij konstatimi mund t'i theksojmë dhe t'i veçojmë disa orientime të kritikës sipas metodave që përdorin. Në fillim të shekullit në Rusi shfaqet i ashtuquajtur i „formalizmi rus“, që në vlerësimin e letërsisë nisat kryekëput nga forma, e thua jse në të njëjtën kohë në sferën anglosaksone shfaqet „kritika e re“, njukriticizmi, që bazohet në teorinë psikologjike dhe semantike, kurse në Evropë, me zbulimet e Frojdit zë të zhvillohet

<sup>5</sup> Rolan Bart. *Književnost, mitologija, semiologija*, Nolit, Beograd, 1971, f. 237.

<sup>6</sup> Svetozar Petrović. *Priroda kritike*, Liber, Zagreb, 1972, f. 319.

<sup>7</sup> Shih: Anica Savić-Rebac. *Antička estetika i nauka o književnosti*, Kultura, Beograd, 1955, sidomos kapitullin *Osnovi i počeci*, f. 37–60 dhe *Prvi sukob filozofije i poezije*, f. 76–80.

<sup>8</sup> Aristotel. *O pesničkoj umetnosti*, Beograd, 1966, f. 34–37. Botimi shqip: Aristoteli. *Poetika*, Prishtinë, 1967, f. 95–101.

<sup>9</sup> Sipas Miroslav Bekër. *Moderna kritika u Engleskoj i Americi*, Liber, Zagreb, 1973, f. 11.

kritika psikoanalitike. Njëherësh dominon edhe kritika e Kroçes, që veprën e interpreton në bazë të ekuacionit intuicioni-ekspresioni, si dhe kritika stilistike-afektive e Shpicerit. Pas luftës së fundit inkuadrohen edhe metoda të tjera. Më të dukshme janë: kritika e realizmit socialist në BRSS, që letërsinë e konsideron si pasqyrim të realitetit objektiv në kuptimin dogmatik; kritika marksiste evropiane që nis me Llukaçin e zhvillohet me Goldmanin e të tjerë në aspekte të ndryshme; kritika ekzistencialiste e Sartrit, që veprën e shqyrton nga aspekti i angazhimit specifik dhe i realitetit ekzistencial; kritika ontologjike e Hajdegerit, që veprën e shqyrton si genie artistike, duke shpjeguar më parë qenësinë e botës e pastaj qenësinë e saj; kritika fenomenologjike e Ingardenit që artin letrar e vë në reduksionin fenomenologjik, ta kërkojë si fenomen të pastër intencional në bazë të metodës fenomenologjike të Huserlit; kritika hermeneutike gjermane që kërkon kuptimësinë e veprës, po ashtu kritika gjermane e interpretimit e aplikuar nga E. Shtajgeri, që kërkon një mjeshtri thjesht letrare në interpretimin e veprës, pastaj kritika e re franceze, që bazohet në strukturalizmin në fushën e gjuhësisë së përgjithshme të filluar nga Sosyri dhe të strukturalizmit në disa shkencë humanitare ku e inkuadroi Klod Levi-Stors, që e zhvillon Rolan Barti kryesisht, e cila veprën letrare e merr si strukturë gjuhësore dhe si shenjë semiologjike. Dhe të gjitha këto metoda në lëmët e tyre të hulumtimit kanë dhënë rezultate të dukshme.

Meqenëse në këto metoda të ndryshme shumë pikënisje janë të përbashkëta, me një reduktim dhe me një përgjithësim metodologjik do të mund të nxirnim dy baza orientuese metodologjike nga të cilat nisët kritika letrare. E para: që vepra letrare, letërsia të merret si produkt historik-shoqëror. E dyta: që vepra të konsiderohet si produkt absolut artistik.<sup>10</sup> Po e vendosëm këtë çështje në sferën e estetikës, do të thotë që vepra të merret si *mimesis* dhe si *poiesis*, si pasqyrim, si shprehje dhe si krijim, siç e përkufizon terminologjia bashkëkohëse. Prandaj rreth këtyre dy sintezave metodologjike ka pasur dhe ka dogmatizme të ndryshme. Përshembull kritika në BRSS e ka dogmatizuar shumë çështjen e konsiderimit të letërsisë si produkt shoqëror, duke e shndërruar atë në një pasqyrim të thjeshtë të këtij relacioni. Po ashtu edhe disa orientime të kritikës, zakonisht në Perëndim kanë rënë në ekstremitetin tjetër duke e marrë letërsinë si të izoluar nga konteksti shoqëror-historik. Ndërsa marksistët evropianë e kanë emancipuar metodën marksiste, që merret kryesisht me aspektin shoqëror-historik dhe e kanë pasuruar me pikëpamje të reja të çliruara, jo në kuptimin pozitivist të këtij relacioni, po duke i kërkuar këto në strukturën e veprës. Në metodologjinë e studimit të letërsisë në Jugosllavi, studjuesit dhe kritikët nisen nga baza e përgjithësuar që letërsinë ta shqyrtojnë si produkt shoqëror-historik dhe

<sup>10</sup> Një përgjithësim të këtillë e bën edhe studjuesi polak Henrik Markjeviç në kapitullin *Vëllimi dhe drejtimit në studimet letrare* në librin *Nauka o književnosti*, Nolit, Beograd, 1974, f. 15—46, po me një ndryshim se, këto i quan analitike dhe marksiste. Këtë libër nuk e pata në dorë kur e shkruaja këtë punim.

si produkt absolut artistik.<sup>11</sup> Si përfundim pas kësaj mund të sjellim se letërsia mund të studjohet nga të dy këto baza metodologjike që varet nga metodat orientuese që i përmendëm më lart, sepse që të dyjat kanë dhënë rezultate të dukshme. Me këtë përgjithësim të bazës metodologjike nuk kërkojmë të bëjmë ndonjë kompromis artificial, kjo mbetet çështje e kritikut dhe e studjuesit nga do të orientohet ai, sepse vetëm në këtë zgjedhje kritika e kryen funksionin e saj.

E ngjashme me këtë përgjithësim metodologjik është edhe ndarja e Velekut dhe e Vorenit në *Teorinë* e tyre: në studim të jashtëm dhe në studim të brendshëm të letërsisë.<sup>12</sup> Është interesant një mendim i mëvonshëm i njërit prej këtyre autorëve, i Velekut, i cili e revidon konstatimin e vet duke pohuar se stili, do të thotë letërsia, të merret si produkt i pandashëm shoqëror-historik e artistik dhe se e ka theksuar shumë ndasinë midis studimit të brendshëm dhe të jashtëm.<sup>13</sup>

Nga ky vështrim i përgjithshëm dhe i shkurtë, ndoshta edhe tepër i dendur me material, më duket se del më i qartë koncepti i kritikës dhe i metodave të saj. Pra kritika letrare, si disiplinë e shkencës së letërsisë gjendet midis teorisë dhe artit letrar, më përgjithësisht, ajo qëndron midis shkencës dhe artit. Kritika, gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të veprës, mund të dalë edhe në sfera të tjera të teorisë, po me kusht që vazhdimisht t'i kthehet veprës letrare. Ndoshta është adekuat mendimi i Zhan Starobinskit se kritika, sa herë që ka mundur të largohet në vështrimin e vet, gjykimi kritik i saj, gjithmonë është shfaqur me letërsinë dhe kanë thithur bashkë të njëjtin ajër.<sup>14</sup> Pra kritika është e lidhur ngushtë me objektin e vet, me letërsinë, apo siç thuhet shkurtas, kritika është një lexim inteligjent, të cilin mendim nuk po e antcipojmë po që do të thotë shumë.<sup>15</sup> Është e kuptueshme se në një punim kritik nuk mund të zbatohen të gjitha metodat, po duhet që kritiku të orientohet në një metodë, ta njohë mirë atë, e kështu të japë kritikë të specializuar shkencore, që e arsyeton metoda e tij.

### 3. Çështja e trajtuar në kritikën tonë

Pas kësaj, do të thotë pas analizës informuese që bëmë rreth orientimeve në kritikën e përgjithshme, ku i nxorëm dy baza të përgjithshme metodologjike: e para, shqyrtimi i letërsisë në aspektin shoqëror-historik, e dyta, shqyrtimi i letërsisë si produkt absolut artistik, të shohim se sa janë të pranishme këto aspekte të këtyre bazave në kritikën tonë. Por gjithnjë duhet të kemi parasysh faktin

<sup>11</sup> Zoran Konstantinović, *Devet metodoloških beleški* në Treći program, RB, nr. 6/70, Beograd, f. 405.

<sup>12</sup> Velek / Voren, *Teorija književnosti*, Nolit, Beograd, 1965 (shiko në tërësi).

<sup>13</sup> Velek, *Stilistika, poetika i kritika*, Republika, Zagreb, nr. 12/73, f. 1311.

<sup>14</sup> Zhan Starobinski, *Novi pravci krit. istraživanja*, Savremenik, Beograd, nr. 7/66, f. 16.

<sup>15</sup> Gream Graf, *Granice kritike*, Savremenik, nr. 11/70, f. 341.

historik se kritika jonë filloi të zhvillohet me vetë letërsinë në formë të recensioneve dhe të vështrimeve të shkurta, duke mos pasur farë baze nga do t'ia fillonte, pra kryesisht qëndronte në shfaqjen empirike të saj, e nxitur vetëm nga veprat letrare. Në këtë fillim, kritika, pa pasur bazë të mjaftueshme teorike, veprën letrare, letërsinë, e shqyrtonte vetëm në aspektin e ngushtë sociologjik, që do të thotë se shpesh i është larguar objektit të vet prandaj të shumtën e herave ka rënë edhe në pozitivizëm e në empirizëm dhe nuk ka pasur aftësi ta interpretojë si duhet veprën. Por, për një kohë të gjatë, kjo kritikë ka kryer rolin, jo vetëm të një ndërmjetësuasi, po edhe rolin e një stimuluesi të letërsisë sonë, ka përshëndetur dhe ka nxitur që të krijohen vepra të reja. Duke u gjendur në një pozitë të këtyre, ka rënë edhe në entuziazëm, sa që ka dhënë edhe impresione lidhur me veprat e ndryshme. Në kuadër të kësaj kritike vërehen shenja të teorisë së pasqyrimin, të reflektuara nga teoria e realizmit socialist, po megjithatë kjo kritikë nuk e inicone një letërsi thjesht si „fotografim”, po një letërsi me një funksion më të madh shoqëror. Më duket se për këtë kritikë më së miri flitet në një artikull të Hasan Mekullit me titull „Letërsija dhe funksioni i saj shoqëror”,<sup>16</sup> në të cilin autori shpreh qëndrimin e vet ndaj letërsisë si dhe metodën e kërkesat që i shtron ndaj letërsisë. Duke u nisur nga teoria e Gjergj Lllukaçit e arsyeton funksionin e letërsisë në shoqëri, që do të thotë se i largohet teorisë dogmatike. Ndër këto fillime të kritikës hyn edhe kritika e Vehap Shitës.

Kurse kritika e sotme gjendet në kuadër të këtyre dy bazave metodologjike që i përkufizuaam në pjesën e parë. Kjo kritikë ka kontakte më të drejtpërdrejta dhe më të qëndrueshme me teorinë e përgjithshme mbi letërsinë. Ka krijuar relacione më të qëndrueshme midis teorisë së letërsisë, historisë së letërsisë, estetikës dhe midis teorisë së përgjithshme shkencore e filozofike sa që ka zënë edhe të specializohet, ta përdorë më shumë dhe më me vend argumentin teorik. Pra ka dalë nga faza empirike-praktike, i shqyrton problemet dhe çështjet e ndryshme pavarësisht në rrafshin teorik e historik.

Në aspektin që kemi në shqyrtim, çështje më vete paraqet kritika e Rexhep Qosjes, që mund ta konsiderojmë si një fizionomi më të plotë, e cila e plotëson dhe i inkuadron disa relacione që i mungonin kritikës, si ato të teorisë, të historisë e të estetikës. Qëndrimin e vet ndaj çështjeve teorike letrare autori e ka dhënë edhe në disa punime teorike mbi letërsinë.<sup>17</sup> Kështu në vlerësimet e tij, duke njohur historinë dhe dishiplinat e tjera letrare, jep gjykime dhe shqyrtime më të qëlluara, ku del i qartë qëllimi metodologjik i autorit që veprën letrare, në të njëjtën kohë e shqyrton në kontekstin shoqëror-historik dhe në atë artistik. Kjo sintezë këtu është më e dukshme, që përmes metodës së përgjithshme të autorit realizohet herë më pak e herë më shumë. Kështu zgjerohet fushëveprimi i gjy-

<sup>16</sup> Shih: Përparmi, nr. 11/1960, f. 735-747, Prishtinë.

<sup>17</sup> Shih sidomos pjesën *Historia dhe kritika letrare në Kontinuitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 245-329.

kimit dhe i vlerësimit kritik. Kjo kritikë përmban në vete vija të përgjithshme të kritikës, të cilat i janë dashur më parë kritikës sonë. Nëse bëjmë një krahasim në bazë të funksionit historik, përkahtendimet e saj ambicioze, këtë kritikë mund ta krahasojmë me kritikën e kritikëve të njohur, të Sent-Bevit, të De Sanktisit, të Bjelinskij, apo të Edmund Vilsonit. Të kuptohet: përkaht vlera dhe rëndësia që ka për kritikën dhe për letërsinë tonë, sepse ka shtruar dhe shpesh ka zgjidhur probleme vitale në këtë fushë. Këtë krahasim nuk mund ta marrim të mundshëm në qarkun thjesht teorik sepse autori i përket një kohe tjetër dhe rrethanëve të tjera shoqërore-historike e artistike. Në kritikën e këtij autori gjejmë trajtim shumë nga teoritë e kritikës evropiane dhe të teorisë së përgjithshme që i përgjigjen konceptit kritik të tij, që veprën letrare e konsideron si një totalitet shoqëror-historik dhe artistik. Ndoshta ky autor më vonë do ta lërë gjerësinë dhe kompletësinë të cilën e ka krijuar dhe do të japë ndonjë kritikë më speciale, sepse është vështirë të mbahet kjo në kohën kur studimet disiplinare edhe në kuadër të vetë studimit të letërsisë janë të dukshme. Në aspektin e teorisë së përgjithshme, në këtë kritikë mund të dallojmë thekse të veçanta të problematikës humaniste-etike të letërsisë. Kështu e ashtu kjo kritikë ka krijuar një gjerësi dhe një shqyrtim të shumanëshëm të problematikës së letërsisë e cila krijon mundësi që në vazhdim të dezintegrohet në disiplina të ardhshme të studimit të letërsisë, ka krijuar një bazë më të vulltshme për realizimin e këtij procesi të rëndësishëm, e cila e ka ngritur kritikën tonë veçanërisht në aspektin metodologjik-teorik, si me inkudrimin e metodave të ndryshme, ashtu edhe me inkudrimin dhe me interpretimin e teorisë.

Kritika e tashme e Hasan Mekulit, me gjithë evoluimin që ka bërë, i mbetet vazhdimisht besnike metodës, teorisë së orientimit sociologjik, por pa entuziazmin dhe pa impresionin e mëparshëm, të cilën gjë e ka kushtësuar stabiliteti më i madh i letërsisë dhe i kritikës. Përmes kësaj metode e teorie, autori ka dhënë analiza të vlerëshme në këtë aspekt, po duhet që ta thellojë edhe më pikëpamjen e tij metodologjike, ta sistemojë, të mos shkojë aq shumë në gjerësi të papërceptuar mirë teorikisht. Kritika e Ali Aliut, me theks të veçantë humanist, përkundër disa rezultateve të mira në depërtim të njohjes së veprës letrare, nuk e ka aq të mjaftueshme bazën teorike dhe aq të njëjshme metodën, prandaj shpesh mbetet në nivel të intuicionit dhe të hetimit të problemit. Si duket më shumë interesohet për njeriun në përgjithësi dhe për njeriun e veprës se sa ta shqyrtojë atë si produkt artistik. Kritika e Hysni Hoxhës, me gjithë precizitetin që autori përpiqet t'i japë në hulumtimin e aspektit stilistik, shpesh bie në mekanicizëm, shpesh sillet në qarkun e kritikës tematike-stilistike, pa ndonjë koncept të theksuar, por që ka vlerë vetëm si inkudrim e jo edhe si rezultat. Kritika e Ali Jasiqit, që me çdo kusht përpiqet ta trajtojë kryekëput aspektin shoqëror të artit, bie në sociologjizëm dhe në përfolje të veprës e të letërsisë, pa argument të mjaftueshëm teorik, pa metodë të caktuar e të verifikuar, duke mos u kujdesur ta

zhvillojë kritikën e vet në një metodë të mirëfilltë sociologjike. Këtu duhet të përmendim edhe kritikën e Sabri Hamitit, e cila mund të konsiderohet si kritikë e aspekteve të veprës letrare. Pra ky autor, kryesisht e hulumton dhe e interpreton artin e veprës, po vlerën e këtij arti e lidh me kontekstin më të gjerë. Disponon me argumentin teorik, me përcaktimin e metodës, po në raste të tilla duhet t'i largohet shprehjes eseistike kur flet për problemet teorike; anon nga metoda e kritikës më të perfeksionuar që sjell aksepte të reja në kritikën tonë.

Ky vështrim i aspektit metodologjik të kritikës sonë, konkretisht përmes kritikës së autorëve, tregon se, kritika jonë, marrë në tërësi është ngritur në një nivel të dukshëm teorik, që i krijon argumentim më të qëndrueshëm. Marrë historikisht kritika jonë e fillimit e ka kryer rolin e vet, po kritika e tashme do ta plotësojë funksionin e duhur vetëm në saje të ngritjes së mëturjeshme në këtë pikëpamje, në zgjedhjen dhe në zbatimin e metodave adekuate të interpretimit të veprës letrare dhe të letërsisë, me një konsekuencë dhe me një njohuri me të plotë teorike.

#### 4. Aksepte përfundimtare

Këtë akseptim me një vështrim mbi metodologjinë e kritikës në përgjithësi dhe të kritikës sonë, që mund të merret si një teori e kritikës, nuk e bëra me qëllim që t'i kundërvëj këto, sepse ajo, e para, është rezultat kolektiv i kombeve evropiane e botërore, por me qëllim tjetër që të veçojmë se sa është në kontakt dhe sa korrespondon kritika jonë me bazën e kritikës së përgjithshme. Në mos tjetër, atëherë kritika jonë gjendet në vijën e përgjithësimit metodologjik që bëme, e që ka mundësi të zhvillohet edhe në kuadër të metodave të veçanta. Por një gjë duhet të theksojmë, se po deshmë që kritika jonë të ketë bazë më të qëndrueshme metodologjike e teorike, së pari duhet të jetë e hapur ndaj metodave dhe teorive që i shqyrtoam, t'i shfrytëzojmë rezultatet e tyre dhe t'i pranojmë ato në mënyrë kritike, çfarë në njëfarë mase po e bën edhe tash, e vetë ky fakt tregon aftësimin e saj, që veprën, letërsinë, ta konsiderojë dhe ta shqyrtojë si realitet të veçantë artistik, si ekuivalent dialektik të realitetit, të jetës, të shoqërisë, të individit dhe të kohës.

*Ibrahim Rugova*

#### LES INTERPRETATIONS METHODOLOGIQUES ET THEORIQUES DE LA CRITIQUE LITTERAIRE

##### R é s u m é

Ce travail traite des aspects méthodologiques et théoriques de la critique littéraire albanaise au Kosovo. La première partie de cette étude examine les problèmes de la critique littéraire dans le cadre de la critique européenne et anglo-américaine. Ainsi, l'auteur présente une vue générale typologique —

théorique sur la critique du XX<sup>e</sup> siècle, pour faire ressortir les deux bases méthodologiques de la critique en général: l'aspect socio-historique de l'étude (marxiste) et l'étude de la littérature comme une création artistique absolue. Dans la deuxième partie de ce travail, l'auteur constate que la critique littéraire albanaise du Kosovo de ses débuts (1945) jusqu'à nos jours a été impliquée dans le cadre de ces deux bases. Pourtant, elle a été plus ou moins en contact théorique avec les courants et les tendances de la critique européenne de notre siècle.

L'auteur constate aussi, que la critique contemporaine albanaise au Kosovo a abandonné l'élément empirique momentané pour se créer une autonomie; d'une part elle a développé et approfondi davantage la base de l'étude socio-historique et d'autre part elle est en train d'affermir la base de littérature comme création artistique et esthétique absolue; cette dernière devenant le centre des études critiques. En conséquence, elle est aujourd'hui en contact continu avec la critique européenne, ce qui démontre son développement successif et son aptitude autonome à l'étude de la littérature albanaise du Kosovo.